

BIO Ambasador Fagu për Këshillin e Ambasadorëve Shqiptar.

Ambasador Fagu ka lindur në Tiranë, Shqipëri dhe është një nga themeluesit e Këshillit të Ambasadorëve Shqiptar si dhe një diplomat i respektuar dhe i kalitur me një eksperiencë shumë vjeçare pranë Shërbimit të Punëve të Jashtme.

Në fillimet e karrierës së tij ka qenë pedagog pranë Shkollës së Mesme të Gjuhëve të Huaja.

Për më tepër se dhjetë vjet përgjatë 1989-1992 ka punuar pranë Ministrisë së Tregtisë së Jashtme- Albimpeks ku mori pjesën më të madhe të eksperiencës së tij diplomatike dhe tregtare të cila i shërbeu në detyrat e tij të ardhshme.

Gjatë karrierës së tij ka shënuar një sërë arritjesh duke përmendur këtu Deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe Ambasador i Britanisë së Madhe dhe Republikës së Irlandës në vitet 1997 deri në 2002.

Në vitet 1898-1992 ai ka punuar pranë Ambasadës së Shqipërisë në Athinë, Greqi pranë departamentit të Tregtar.

Në vitet 2003-2006 ai shërbeu si Drejtor, në Drejtorinë për Demokraci dhe Siguri (NATO, CiE dhe OSBE), në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Duke filluar nga 2006 deri në 2013 ka shërbyer si drejtor, Drejtoria e NATO-s, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Paralelisht me karrierën diplomatike zoti Fagu ka kontribuar dhe në zhvillimin e sportit në Shqipëri dhe përfaqësimin e tij jashtë vendit nëpërmjet kontributit të dhënë si President i Komitetit Olimpik Shqiptar, i zgjedhur në këtë pozicion në vitin 2009.

Me përfundimin e shërbimit të tij pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe daljes në pension i është rikthyer dashurisë së tij për sportin duke u zgjedhur në mënyrë unanime si Presidenti i Shoqatës Partizani Basket, skuadrës së mirënjohur dhe me traditë.

Ambasador Fagu është një nga yjet e basketbollit shqiptar dhe fitues i shumë trofeve si kombëtare ashtu dhe ndërkombëtare dhe një figurë e shumë admiruar në historinë e sportit.

Medalje/Çmime

1971 Naim Frashëri Klasa e Dytë

1996 Naim Frashëri e Artë

2017 Urdhëri i Skënderbeut

1968 Nderuar nga presidenti i FIBA-s me “Distiktiv Nderi”

1969 Përzgjedhur në Skuadrën Europiane